



SHKOLLA PËR TË GJITHË

RAPORT I VIZIONIMIT TË PUNËTORISË PËR OBJEKTIN
SHKOLLOR DHE REHABILITUES PËR PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUARA

JANAR, 2017

SHKOLLA PËR TË GJITHË

RAPORT I VIZIONIMIT TË PUNËTORISË PËR OBJEKTIN SHKOLLOR DHE REHABILITUES PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

*Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit **Prizreni, një qytet pa pengesa**, që përkrahët financiarisht nga USAID, programi E4E dhe mbikëqyret nga ATRC dhe implementohet nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK.*



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



PËRMBAJTJA:

0.0. Hyrje

1.0. Punëtorja e vizionimit 'Shkolla për të gjithë'

- 1.1. Qëllimi i punëtorisë
- 1.2. Metodologjia dhe mjetet e punës
- 1.3. Materialet e punëtorisë
- 1.4. Pjesëmarrësit e punëtorisë

2.0. Rezultatet nga punëtorja

- 2.1. Te gjeturat nga faza e identifikimit
 - 2.1.2 Rrëfimet personale dhe listimi i problematikave kryesore
- 2.2. Konkluzionet nga faza e propozimit
 - 2.2.1 Propozimet në aspektin përmbajtësorë të objektit 'Shkolla për të gjithë'
 - 2.2.2 Propozimet për enterierin e objektit 'Shkolla për të gjithë'

3.0. Rastet e studimit përgjatë dizajnit të objektit 'Shkolla për të gjithë'

4.0. Principet e projektimit të objektit 'Shkolla për të gjithë'

- 4.1. Qasja gjithëpërfshirëse dhe përshtatshmëria me nevojat speciale
- 4.1. Trajtimi i lokacionit dhe rrethinës
- 4.2. Qasja dhe komunikimi
- 4.3. Organizimi i njësive dhe parametrat e rëndësishëm gjatë projektimit të tyre
- 4.4. Përmbajtjet përcjellëse
- 4.5. Atributet teknike

5.0. Vizionimi i objektit shkollor dhe rehabilitues 'Shkolla për të gjithë'

- 5.1. Koncepti
- 5.2. Shtrirja funksionale dhe përshkrimi i projektit

6.0 Shtojcat

- 6.1. Pyetësori
- 6.2. Projekti konceptual 'Shkolla për të gjithë'

HYRJE

Edhe pse e drejta për vijim të shkollimit është e siguruar me Ligjin për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës, personat me aftësi të kufizuara rezultojnë ta kenë pothuajse të pamundur vijimin e shkollimit elementar. Është ky ligj që promovon një sistem arsimor jo-diskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për mundësi shkollimi. Madje sipas po këtij ligji, institucionet shkollore kanë për detyrë promovimin e politikave gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me dobësi dhe aftësi të kufizuara në sistemin arsimor. Gjithëpërfshirja është poashtu njëra ndër prioritetet e Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional.

Komunitet janë ato të cilat kanë për detyrë monitorimin e zbatimit të këtij ligji në fuqi, duke u siguruar në respektimin e standardeve sa i përket arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm. Megjithatë, nxënësit me aftësi të kufizuara mbeten larg oborreve shkollore, të diskriminuar nga e drejta për shkollim. Rezultatet e punëtorisë 'Shkolla për të gjithë' dëshmojnë për një numër të konsiderueshëm të nxënësve të cilët e kanë ndërprerë shkollimin si rezultat i pa mundësisë për ta vijuar atë në objektet shkollore të cilat nuk ofojnë qasje për PAK (Persona me Aftësi të Kufizuara) apo nuk kanë patur fatin asnjëherë ta fillojnë atë.

Institucionet lokale të arsimit madje edhe organizatat që në fushëveprim të tyre kanë PAK (Persona me Aftësi të Kufizuara), nuk posedojnë shifra sa i takon numrit të nxënësve potencial me aftësi të kufizuara, e aq më tepër numër të nxënësve të cilët tashmë i kanë ndërprerë mësimet, duke dëshmuar edhe njëherë më shumë për trajtimin jo-serioz të kësaj problematike. Agjencia e Statistikave të Kosovës lë shumë për tu nënkuptuar në shifrat e dhëna në raportin 'Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015-16'. Nga 258,464 nxënës të arsimit fillor dhe të mesëm, ky agjension liston 5,815 nxënës me aftësi të kufizuara në rradhët e klasave të rregullta, duke dhënë si vërejtje faktin që ky numër është i përafërt për faktin që akoma nuk janë vlerësuar të gjithë nxënësit me aftësi të kufizuara që janë në klasat e rregullta nga ekipet vlerësuese profesionale në komuna. Në anën tjetër nga po i njëjti agjension numri i nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët vijnë shkolla speciale rezulton të jetë 357 në total, duke numëruar këtu nxënësit me dëmtime intelektuale, dëmtimet në të dëgjuar, dëmtimet në të parë, dëmtimet fizike, dëmtime të shumëfishta, vështirësi në të folur dhe komunikim, autizëm, çrregullime emocionale dhe të sjelljes, vështirësi/ çrregullime në të nxënë dhe Sindrom Doun.

Ky hulumtim nuk nxjerr si masë krahasuese numrin e nxënësve potencial me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë patur rastin që të bëhen pjesë e sistemit të arsimit në Kosovë, duke pamundësuar pasqyrimin e gjendjes reale të numrit të fëmijëve të

izoluar në ambiente shtëpiake e të diskriminuar nga e drejta për shkollim. Megjithatë, zërat individualë të përfshirë në këtë hulumtim dëshmojnë për pamundësinë e një numri të konsiderueshëm të nxënësve me aftësi të kufizuara në vijimin e mësimave për arsyë të jo-përshatshmërisë së objekteve shkollore për nevoja të tyre, mos përshtatshmërisë me kurrikulën e mësimi, pamundësisë për transport deri te objektet shkollore, diskriminimit ditor ushtruar në bazë të dëmtimeve dhe pengesave të tyre etj.

Rëndom këta fëmijë dhe nxënës potencial botërisht janë stigmatizuar me kërkesën për trajtim të veçant duke u thirrur në 'nevojat e veçanta' që ata kanë. Duke u nisur nga kjo, shumë pak i është kushtuar rëndësisë së vet dizajnit dhe projektimit të standardizuar për kërkesat e tyre, si një komponentë e rëndësishme për vijimin e rregullt të mësimi. Shumë më shumë është trajtuar aspekti social dhe i shërbimeve sociale të ofruara për ta, se sa ai edukativ. Deri në vitet e 80ta, nxënësit me aftësi të kufizuara janë parë t'i takojnë vetëm institucioneve speciale, duke i mënjeluar ata nga klasët e rregullta. Fatmirësisht dekadat e fundit dëshmojnë për përmirësim të dukshëm të kësaj situate, duke i bërë këta nxënës pjesë të komunitetit. Me këtë ndryshim nis trajtimi i objekteve shkollore dhe përshtatja e tyre për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara, varësisht nga pengesat dhe kërkesat e tyre të veçanta, duke e bërë dizajnin si komponentë të rëndësishme në integrimin dhe gjithëpërfshirjen e tyre. Gradualisht objektet e veçanta për një kategori të caktuar të nxënësve me aftësi të kufizuara integrohen në shkollat e rregullta. Britania e Madhe në vitin 1994 zotohet për përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në shkollat nacionale, duke hapur rrugë edhe për iniciativë të tjera në shtetet fqinje Evropiane. Edhe pse rastet e integrit të nxënësve me dëmtime të caktuara në zhvillim dhe kërkesa të veçanta kanë dëshmuar edhe në jo-efektivitet për shkak të vështirësisë në përshtatshmëri, në gjenerale kjo iniciativë ka zbehur ndjenjën e të qenit 'ndryshe' dhe me 'nevoja të veçanta' apo i 'kufizuar'.

Përparësitë e integrit të nxënësve me aftësi të kufizuara në klasat e rregullta kanë rezultuar të jenë të shumta, duke i pregaditur të dy grupet, fatkeqsisht figurativisht të ndara, në përgjegjësinë e të jetuarit dhe funksionuarit në një shoqëri të përbashkët.

Në Kosovë, edhe pse e rregulluar me Ligjin për Arsim dhe e prioritetizuar si një nga synimet kryesore në nivel të institucionit më të lartë të arsimit, MASHT, gjithëpërfshirja rezulton të jetë larg arritjes sa i përket shkollave në komunat më të mëdha, përfshirë këtu edhe Prizrenin si rast studimi në këtë punëtori.

1.0. PUNËTORIA E VIZIONIMIT 'SHKOLLA PËR TË GJITHË'

1.1. Qëllimi i punëtorisë

Punëtorja e vizionimit të 'Shkollës për të gjithë' është realizuar në kuadër të projektit 'Prizreni, qytet pa pengesa' përkrahur nga USAID dhe implementuar nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK (Organizata e Personave me Distrofi Muskulare të Kosovës). Punëtorja, bazuar në objektivat e projektit, ka për fokus rritjen e përfshirjes së Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK) në projektimin e Prizrenit pa pengesa duke targetuar vet Personat me Aftësi të Kufizuara dhe nxënësit e shkollave të qytetit të Prizrenit.

Nisur nga hulumtimet në kuadër të projektit 'Prizreni, qytet pa pengesa' dhe vizitat e shumta në objektet shkollore të Komunës së Prizrenit, është parë e nevojshme realizimi i një punëtorie e cila do të kishte për produkt vizionin e një shkolle model, e cila do të shërbente personave me aftësi të kufizuara, varësisht nga nevojat specifike të tyre, dhe do të mundësonte vijimin e shkollimit të rregullt. Qëllimi i punëtorisë 'Shkolla për të gjithë' është fillimisht identifikimi i mangësive në objektet shkollore ekzistuese, arsyeve të cilat kanë dërguar deri në ndërprerjen e shkollimit të nxënësve me aftësi të kufizuara si dhe gjetjes së formulës së mundshme që ata të mund të integrohen në klasat e rregullta.

Rrjedhimisht, punëtorja ka për qëllim gjithëpërfshirjen në procesin e dizajnit të një objekti shkolle i cili do të eliminonte barrierat aktuale në ndarjen e dy grupacioneve, të nxënësve që i takojnë shkollave speciale dhe atyre që i takojnë shkollave të rregullta. Duke i përfshirë të gjitha kategoritë në fazat e ndryshme të punëtorisë dhe të dizajnit të projektit konceptual të shkollës model, kjo punëtori synon diskutimin e praktikave jo të mira të deritanishme në shkollat aktuale dhe propozimin e shkollës ideale varësisht nga pengesat apo kërkesat e veçanta të tyre.



Kjo punëtori ka për bazë të gjeturat nga vizitat në terren të shkollave aktuale, hulumtimet paraprak mbi statistikën e përfshirjes së personave me nevoja të veçanta në sistemin aktual të arsimit, analizës së komponentes sociale, shqyrtimin e aspektit të dizajnit të mirë në rritjen e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollimin elementar si dhe praktikën e mira në rajon dhe më gjerë.



Fig.1. Pamje nga punëtorja 'Shkolla për të gjithë'



Fig.2. Plotësimi i pyetësorëve

1.2. Metodologjia dhe mjetet e punës

Punëtorja 'Shkolla për të gjithë' duke pasur për fokus nxënësit me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre dhe nxënësit e klasëve të rregullta, ka patur për metodologji punën konkrete nga identifikimi i barrierave në shkollat ekzistuese, shpalosja e rrëfimeve personale për arsyet e braktisjes së shkollave aktuale, plotësimit të pyetësorëve lidhur me gjendjen e objekteve shkollore dhe barrierave të hasura në to e deri te faza e propozimit të shkollës gjithëpërfshirëse e cila do të plotësonte kërkesat e të gjitha kategorive.

Kjo punëtori është organizuar në interval një ditorë, dhe është konceptuar në tri faza të punës, secila prej të cilave ka patur për objektive mbulimin e një sektori të caktuar të problematikës në shkollat ekzistuese, duke përfunduar me fazën e fundit e cila kontribuon direkt në vizionimin e shkollës konceptuale si produkt të kësaj punëtorie.

1. FAZA : ANALIZO DHE IDENTIFIKO

Mjeti i punës: Analizë e fotografive të shkollave ekzistuese dhe plotësim i pyetësorëve

Gjatë fazës së parë të punëtorisë janë shpalosur fotografi të shkollave ekzistuese gjatë vizitave në shkolla të mesme në kuadër të projektit 'Prizreni, qytet pa pengesa'. Janë identifikuar dhe analizuar pengesat e evidente në këto shkolla. Pjesëmarrësit më pas, secili individualisht me përjashtim të nxënësve të cilët kanë patur nevojë për asistencë, kanë plotësuar pyetësorët lidhur me pengesat dhe pakënaqësitë e tyre në shkollat ekzistuese. Kjo fazë ka definuar problematikat kryesore në objektet shkollore të qytetit të Prizrenit dhe në komunat fqinje, duke hapur shumë tema të diskutimit të cilat kanë dërguar në fazën e dytë të punëtorisë.

2. FAZA: RRËFEHU DHE PROPOZO

Mjeti i punes: Rrëfime personale dhe diskutime në grup

Të ndarë në grupe nxënësit me aftësi të kufizuara kanë rrëfyer lidhur me përvojat e tyre personale të deritanishme me sistemin e edukimit në vend. Varësisht nga rasti, rrëfimet kanë variuar nga arsyet e mos shkuarjes fare në shkollë, rrëfime mbi braktisjen e shkollës pas disa vitesh tentimesh për tu përshtatur në kushtet e shkollave ekzistuese e deri në rrëfimet për tentimin me çdo kusht të eliminimit të barrierave të hasura në këto objekte. Faza e rrëfimeve personale është përdorur si mjet për krijimin e një përshtypje të përgjithshme mbi gjendjen në shkollat vendore dhe problemeve që nxënësit me aftësi të kufizuara përballen çdo ditë. Në mes tjerash kjo fazë ka dërguar në diskutimin e mundësive për përmirësimin e gjendjes aktuale dhe propozime konkrete lidhur me objektin shkollor që do tu plotësonte të gjitha nevojat dhe kërkesat.

3. FAZA: REALIZO

Mjeti i punes: Punimi i maketes konceptuale

Duke patur për produkt propozimin konceptual të objektit shkollor për të gjithë, faza e tretë dhe e fundit e punëtorisë është fokusuar në propozimet konkrete dhe realizimin e tyre në trajtë të maketës. Nxënësit të ndarë në grupe kanë punuar në vizionimin e shkollës ideale për kërkesat e tyre. Ndarja është bërë në dy grupe, ku njëri grup është fokusuar në trajtimin përmbajtësor të objektit të shkollës, ndërsa grupi tjetër në hapësirën publike përreth shkollës. Në këtë fazë janë finalizuar maketat e punës të bazuara në diskutimet e fazës së dytë: PROPOZO. Grupi që ka trajtuar objektin shkollor ka dhënë propozime konkrete lidhur me hapësirat përcjellëse të shkollës të cilat do tu lehtësonin atyre vijimin e klasave të rregullta. Ndërsa grupi që ka trajtuar rrethinën e shkollës ka analizuar faktorët relevantë të cilët do të mund rritnin potencialin e vijimit të shkollimit nga nxënësit me aftësi të kufizuara, duke u nisur nga afërsia e transportit publik, vendparkingjeve, fushëlojave sportive në të hapur etj.

PËRFUNDIMI I PUNËTORISE

Nga një përfaqësues i secilit grup ka prezentuar rezultatet e punëtorisë. Grupi i parë ka prezentuar konceptin e objektit të shkollës model, hapësirat funksionale dhe ndërlidhjen e tyre. Grupi i dytë ka prezentuar përmbajtjet funksionale të hapësirës publike rreth objektit shkollor. Në këtë mënyrë me bashkimin e propozimeve të të dy grupeve është konceptuar vizionimi i objektit shkollor, i cili për më tepër ka rezultuar të jetë më kompleks, duke qenë se pjesëmarrësit e punëtorisë kanë propozuar që ta këtë edhe komponente shtesë (më shumë në spjegimin e konceptit).

Pas përfundimit të punëtorisë, të dhënat nga faza e analizës, diskutimeve, rrëfimeve personale, pyetësorëve dhe propozimeve konkrete në modelin punues, jashtë vënë në shfrytëzim për arritjen e propozimit final lidhur me projektin konceptual të shkollës për të gjithë.

1.2 Materialet e punëtorisë

Me qëllim të realizimit të objektivës së punëtorisë, janë përdorur keto materiale:

- pyetëtori
- fotografi të barrierave të identifikuara në shkollat e vizituara
- ngjyra dhe letra me ngjyrë
- letër për punimin e maketës
- plastelina
- laptop dhe projektor



Fig.3. Asistenca në plotësimin e pyetësorëve



Fig.4. Materialet e përdorura në punëtori

1.3. Pjesëmarrësit e punëtorisë

Punëtorja si komponentë kryesore ka patur pjesëmarrësit nxënës me aftësi të kufizuara, duke tentuar që të ketë nga një përfaqësues nga të gjitha kategoritë. Këtu përfshihen nxënësit me dëmtime intelektuale, dëmtimet në të dëgjuar, dëmtimet në të parë, dëmtimet fizike, vështirësi në të folur dhe komunikim, çrregullime emocionale dhe të sjelljes, vështirësi në të nxënë dhe Sindrom Doun.



Fig.5. Ilustrim i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse në punëtori

Pjesëmarrës të tjerë janë ftuar të jenë prindërit e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nxënësit nga rradhët e klasëve të rregullta. Prindërit kanë prezentuar komponenten e dytë shumë të rëndësishme të pjesëmarrësve, ku me rrëfimet e tyre kanë kontribuar në identifikimin e pengesave kryesore që ata në cilësinë e përcjellësve të fëmijëve të tyre i hasin çdo ditë në shkollat ekzistuese.

Në cilësinë e komponentes së tretë në rradhët e pjesëmarrësve janë përfshirë nxënësit e klasëve të rregullta të cilët kanë ndihmuar në pasqyrimin e gjendjes aktuale në shkollat ekzistuese, duke dëshmuar për diskriminimin e fëmijëve me aftësi

të kufizuara apo në raste të caktuara për mos prezencën e tyre në rradhët e klasëve të tyre, si rezultat i 'mshëfjes' në shtëpitë e tyre.

Të tri komponentet kanë plotësuar qarkun e mbyllur nxënës me aftësi të kufizuara, prindër të nxënësve me aftësi të kufizuara dhe nxënës të klasave të rregullta, duke e shtrirë problematikën e barrierave në shkollat ekzistuese në një tjetër nivel, më kompleks dhe duke patur për bazë tri perspektiva të ndryshme.




Fig.6. Skema e kategorizimit të pjesëmarrësve


Poashtu, gjatë përzgjedhjes së pjesëmarrësve, rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe përfaqësuesve nga shkollat e komunave të tjera të Rajonit të Prizrenit me qëllim të reflektimit të situatës edhe në shkollat e tjera për dallim nga ato me fokus në qytetin e Prizrenit. Kjo përfshirje ka ndihmuar në identifikimin e problematikave të tjera që i rrethojnë këta nxënës, ndër të cilat edhe çështja e transportit deri në shkollën më të afërt.

2.0. REZULTATET NGA PUNËTORIA

Gjatë prezentimit të fotografive nga shkollat ekzistuese, pjesëmarrësit e punëtorisë kanë identifikuar pengesat kryesore të cilat më së shumti kanë të bëjnë me problematikën e qasshmërisë. Pengesat kryesore të dalura nga faza e identifikimit të barrierave në fotografitë dhe pyetësorët, mund të kategorizohen në ato të hasura gjatë shkuarjes në shkollë, dhe pengesat e hasura brenda objektit shkollorë.

Për dallim nga kjo fazë e punës, në fazën e dytë atë të rrëfimeve personale, pjesëmarrësit kanë folur më tepër për përvojat e tyre lidhur me sistemin aktual të shkollimit. Gjatë kësaj faze, nga zërat individual janë identifikuar arsyet e ndërprerjes së shkollimit nga ata prindër që kanë tentur t'i përshtaten gjendjes aktuale në shkollat ekzistuese por që nuk ia kanë dalë për një periudhë shumë të gjatë, arsyet për mos dërgimin fare të fëmijëve në shkollat përreth për arsye të distancës dhe diskriminimit nga stafi aktual si dhe rrëfimet mbi vijimin me çdo kusht të shkollimit, edhe pse të përcjellur me shumë pengesa dhe vështirësi.

2.1. Të gjeturat nga faza e identifikimit






■ HYRJE E PA QASSHME PËR PAK
■ MUNGESË PJERRINE



■ HYRJE E PA QASSHME PËR PAK
■ DYER ME PRAGJE - SHIRIT METALIK



■ HYRJE E PA QASSHME PËR PAK
■ MUNGESË PJERRINE



■ LEVIZJE NË NIVELE GJATË KORRIDOREVE
■ MUNGESË PJERRINE



■ MUNGESË E PLLAKAVE TAKTORE



■ MUNGESË LIFTI



■ TOALETE TË PA QASSHME PËR PAK
■ MUNGESË E GUACËS
■ MUNGESË E MBAJTËSEVE



■ MUNGESË E PLLAKAVE DHE VIJAVE TAKTORE
■ MUNGESË E MBAJTËSVE

Rastet e prezentuara përmes fotografive (dhe të analizuara gjatë punëtorisë) dëshmojnë për problematika të ngjashme në të gjitha shkollat në kuadër të Komunës së Prizrenit. Është me interes të ceket që në shkollat e ndërtuara gjatë viteve '60-'90 nuk janë marrë parasysh çështjet e qasjes së personave me aftësi të kufizuara. Të gjitha objektet shkollore edhe pse të ndërtuara në etazhë, nuk janë të paisura me lift. Hyrjet janë të ngritura në nivel +0,30 deri në +0,60 cm, ngritje kjo e realizuar vetëm përmes shkallëve dhe jo pjerrinave. Toaletet janë poashtu të pa dizajnuara për PAK, mungojnë guacat dhe mbajtëset. Këto dhe shumë problematika të tjera që ndikojnë drejtëpërsëdrejti në vështirësitë e ndjekjes së shkollimit elementar nga nxënësit me nevoja të veçanta, nuk janë eliminuar, edhe pse ekziston mundësia e ndërhyrjeve në objektet ekzistuese dhe adoptimit të tyre për nevoja bashkëkohore. Përrjashtim bën Gjimnazi 'Gjon Buzuku', në të cilën shkollë është intervenuar nga prindërit me qëllim që t'i sigurohet vijimi i mësimi fëmijut të tyre me pengesa fizike.



Fig.7. Insertimi i pjerrinës për qasje të PAK inicuar nga prindërit

Edhe objektet e ndërtuara gjatë viteve të fundit, nuk përmbushin normat minimale të projektimit të objekteve shkollore të qasshme nga PAK. Nga pyetësorët dhe analiza e gjendjes ekzistuese në shkollë, nxënësit me aftësi të kufizuara kanë identifikuar këto problematika kryesore:

PENGESAT JASHT OBJEKTIT TË SHKOLLËS	PENGESAT NË OBJEKTIN E SHKOLLËS
• objektet shkollore në distanca të largëta nga vendbanimet e PAK • mungesë e transportit të organizuar për PAK deri në objektet shkollore dhe anasjelltas • rrugë të pa kaluara nga PAK • trotuare me pengesa • mungesë e pjerrinave • mungesë e pllakave taktore • mungesë shenjëzimi • mungesë e ndriçimit publik • mungesë e mbajtësve • mungesë e ulëseve për pushim	• oborri i shkollës me pengesë në qasje • pllakëzim i dëmtuar dhe i pa nivelizuar në oborrin e shkollës • mungesë e pjerrinave për qasje në shkollë • mungesë e klasave të qasshme për PAK • mungesë e pllakave taktore në shkollë • mungesë e ashensorëve • mungesë e mobiliarit të përshtatshëm për nevoja të PAK • mungesë e toaleteve të qasshme për PAK • mungesë e asitencës mjekësore • mungesë e kthinave për stafin shtesë profesional (punëtorët social, mjeku, etj)

2.1.2 Rrëfimet personale dhe listimi i problematikave kryesore



SHËNIM: Lidhja e rrëfimit me personazhin është e rastësishme, me qëllim të ruajtjes së privatësisë. Rrëfimi nuk përkon me personazhin në foto. Poashtu dy e më shumë rrëfime janë të kombinuara në një.

Nga faza e rrëfimeve, pjesëmarrësit kanë potencuar arsyet kryesore që i kanë shtyer deri të ndërprerja e mësimëve në shkollat ekzistuese. Ndër të tjera, disa prindër dhe fëmijë kanë shpalosur alternativat e gjetura nga ta me qëllim të sigurimit të shkollimit për fëmijët e tyre. Fëmijët nga shkollat e rregullta kanë rrëfyer se ndodh shumë rrallë që të shohin një nxënës me aftësi të kufizuara në rradhët e shkollarëve të tjerë.

ARSYET E BRAKTISJES SË SHKOLLIMIT	ALTERNATIVAT PËR VIJIMIN E SHKOLLIMIT
• objektet shkollore në distanca të largëta nga vendbanimet e PAK • mungesë e transportit të organizuar deri në shkollën më të afërt • kosto e lartë e pagesës së transportit privat deri në shkollën më të afërt • mungesë e qasjes në objektin shkollore • mungesë e toaleteve të qasshme për PAK • trajtim jo i mirë nga ana e mësimeve • pa mundësi e prindërve për t'i derguar dhe pritur fëmijët në shkollë	• shoqërimi i PAK në shkollë nga ana e prindërve • regjistrimi i fëmiut me aftësi të kufizuara në një klasë me motrën, vëllaun apo familjarët e tjerë (me pritje 1/2 gjenerata) me qëllim të shoqërimit të tyre gjatë procesit mësimorë • ofrimi i mësimëve në shtëpi nga prindërit dhe fëmijët e tjerë të familjes me qëllim të plotësimit të mungesave nga mësimi elementar • dërgimi i fëmiut në shkollë të komunës tjetër, atëherë kur komuna amë nuk ofron shkollim për PAK

2.2. Konkluzionet nga faza e propozimit

Faza e tretë e punëtorisë ka dërguar punën në grupe në drejtim të konsolidimit të një ideje të përbashkët lidhur me atë se si një shkollë gjithëpërfshirëse do të dukej. Marrë parasysh problematikat dhe identifikimin e mangësive në shkollat ekzistuese, pjesëmarrësit kanë diskutuar se çka kjo shkollë 'duhet të ketë' e që në shkollat ekzistuese nuk ka, dhe çka 'nuk duhet të ketë', duke aluduar në të metat e shkollave ekzistuese të cilat duan t'i eliminojnë në shkollën model.

2.2.1 Propozimet në aspektin përmbajtësorë të objektit 'Shkolla për të gjithë'

Punimi i maketave për vizionimin e shkollës model ka shprehur më tepër kërkesat për përmbajtjet funksionale në shkollën gjithëpërfshirëse, të cilat janë prezentuar veç e veç nga anëtarët e grupeve.



Fig.8. Faza e punës: PROPOZO, punimi i maketave



Fig.9 Maketa e punës: hapësira përreth objektit shkollor




Fig.10 Maketa e punës: objekti shkollor

2.2.2 Propozimet për enterierin e objektit 'Shkolla për të gjithë'

Përpos propozimeve në aspektin përmbajtësor të shkollës gjithëpërfshirëse, pjesëmarrësit kanë shprehur preferencat e tyre që shkolla të jetë e përshtatshme edhe në dizajnimin e mobiliarit në veçanti dhe enterierit në tërësi. Mobiliat duhet të jenë të përshtatshme për të gjithë nxënësit, duke përfshirë këtu edhe nxënësit shtatëshkurtër, për të cilët mobiliat do të punohen në bazë të specifikave të tyre të lartësisë. Poashtu toaletet duhet të jenë të qasshme për personat me nevoja të veçanta fizike, të paisura me guacë toaleti dhe me mbajtëse. Kërkesë e veçantë janë shenjat identifikuese (me ngjyra) për secilën grupacion përmbajtësor, përmes të cilave nxënësit do të kenë mundësi që të orientohen më lehtë në objekt.

Pjesëmarrësit kanë propozuar që kthinat të projektohen të përshtatshme për shfrytëzim edhe për prindërit, në mënyrë që të krijohet një bashkëpunim në mes të

menagjmentit të shkollës dhe prindërve. Është propozuar që prindërit të angazhohen në pregaditjen e shujtave ditore dhe në asistim të aktiviteteve të lira në kthinën e kujdesit ditorë.

Kërkesë e veçantë nga fazat e punëtorisë ka rezultuar të jetë prania e hapësirave gjelbëruese në kuadër të objektit shkollor. Pjesëmarrësit kanë kërkuar që të tri grupacionet (të spjeguar më gjerë në pjesën e konceptit) të lidhen përmes një haëpsire të brendshme gjelbëruese e cila do tu mundësonte sa më shumë interakcion me natyrën.

3.0. RASTET E STUDIMIT GJATË DIZAJNIMIT TË OBJEKTIT 'SHKOLLA PËR TË GJITHË'

Me qëllim të arritjes së cilësisë gjatë punimit të dizajnit konceptual të shkollës gjithëpërfshirëse, disa raste të shkollave ekzistuese janë marrë parasysh duhet analizuar dizajnin, normativat e aplikuar dhe aspektin funksion të përshtatur për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara.

'BSBO De Bloesem School' në St. Truiden të Belgjikës është dizajnuar nga VBM Architecten dhe konsiston në adaptimin e një objekti shkollor të vitit 1950 dhe shtuarjen e një aneksi për nevojat e shkollimit special. Objekti është në afërsi të qendrës historike, ndërsa klasët janë të grupuara në dyshe, duke patur toaletet në mes. Dizajni është i thjeshtë, me korridore të drejta në mënyrë që për fëmijët të mos krijohet konfuzitet deri në gjetjen e kthinës të cilës i takojnë. Konstruksioni poashtu është i thjeshtë, ndërsa hapjet në fasadë ruajnë masën intime në mënyrë që nxënësit të jenë në përshtatshmëri të plotë me ambientin.



Fig.11. BSBO De Bleoesem School, 2006, Belgium; VBM Architecten

'Stephen Hawkins School' në Londër është shkollë speciale e ndërtuar në periferi të Londrës në një lagje të varfër. Arkitektët nga Haverstock Associates kanë arritur që të krijojnë një oazë të qetë e cila u ofron rreth 90 nxënësve, 4-11 vjeç, asistencë nga stafi profesional. Forma Y e prerjes tërthore siguron masë intime në ambient dhe në të njetjën kohë ndriçim të mjaftueshëm. I rëndësishëm është qarkullimi lehtë i kuptueshëm për nxënësit, si dhe ndjenja e ngrohtësisë përgjatë kthinave të




Fig.12. Stephen Hawkins School, 1997, London; Haverstock Associates

përbashkëta dhe bibliotekës. Ndriçimi i mjaftueshëm u mundëson fëmijëve me pengesa në shiqim orientim më të mirë, ndërsa akustika e mirë u lehtëson qëndrimin fëmijëve me pengesa në shqisën e të dëgjuarit.

'Pistorius School for Disabled Children' në Herbrechtingen, Gjermani është shkollë e dedikuar për nxënësit me aftësi të kufizuara fizike të moshës 6-16 vjeç. Shkolla ka kapacitet për 100 fëmijë dhe sipërfaqja e tërësishme zë 4,450 m². Shkolla funksionon në grupe të ndara nga 5 nxënës në klasë. Arkitektët e fituan konkursin me këtë objekt, bazuar në qëllimin e tyre për edukimin e integruar dhe 'zhytjen' e objektit në natyrë. Ideja e tyre fillestare ishte riprodhimi i ambientit të shtëpisë në një kompleks të një familjeje të madhe, ku fëmijët do të ndiheshin të integruar dhe me besim të plotë në aftësitë e tyre. Në këtë mënyrë ata konceptuan secilën klasë si një 'shtëpi' të veçantë e cila funksiononte e shkëputur nga njësitet e tjera, por në të njejtën kohë e integruar në familjen e madhe, e që ishte institucioni shkollor. Në të njejtën kohë arkitektët punuan në integrimin e klasëve me ambientin e jashtë, duke qenë se sipas tyre, integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në botën reale është një prej komponenteve më të rëndësishme.

Rëndësi e posaqme në këtë shkollë i është kushtuar dizajnit të pishinës terapeutike dhe ndriçimit natyror në të. Lidhja e pishinës me tryezarinë dhe hollin hyrës dhe ndriçimi natyror i arritur në këto kthina, u motivon nxënësit në shfrytëzimin maksimal të tyre. Për më tepër, konceptimi i të gjitha hapësirave është bërë në krijimin e një rendi të përgjithshëm, duke ndihmuar nxënësit në arritjen e qetësisë dhe koncentrimin në angazhimin e tyre ditorë të ngritjes intelektuale dhe aftësimit në shoqëri.




Fig.13. Pistorius School for Disabled Children, 2005, Gjermani; Behnisch & Partner

4.0. PRINCIPET E PROJEKTIMIT TË OBJEKTIT 'SHKOLLA PËR TË GJITHË'

Për të arritur gjithëpërfshirjen dhe të drejtën për shkollim të secilit fëmijë, patjetër se duhet kushtuar kujdes në projektimin e objekteve shkollore të cilat në aspektin përmbajtësor dhe atë fizik u përshtaten edhe nxënësve me aftësi të kufizuara. Projekti konceptual për objektin shkollor dhe rehabilitues 'Shkolla për të gjithë' është bazuar në buletin anglez për projektimin e shkollave speciale 'Projekimi për fëmijë me aftësi të kufizuara dhe fëmijë me kërkesa të veçanta në sistemin e edukimit'.

Shkolla për të gjithë synohet të jetë një institucion i përshtatshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara së bashku me nxënësit e klasave të rregullta, në partneritet me prindërit dhe stafin e mësimdhënësve. Gjithëpërfshirja në procesin e dizajnit është element kryesorë në arritjen e një mjedisi bashkëpunues.

Është shumë e rëndësishme që në fazën e projektimit të një shkolle gjithëpërfshirëse të mirren parasysh këto tri komponente:

A. Përcaktimi se për kë dedikohet ky objekt

Është e rëndësishme që të analizohen të gjitha kategoritë e pengesave që nxënësit potencialë kanë, në mënyrë që ato të mirren parasysh gjatë fazës së projektimit. P.sh. theksi mund të bie në problemin e qasshmërisë, procesin e mësimi dhe perceptimit, çështjeve emocionale dhe aspektit social, komunikimit dhe ndërveprimit etj. varësisht nga kategorie e nxënësve me aftësi të kufizuara.

B. Gjithëpërfshirja në aspektin përmbajtësor

Bazuar në përcaktimin e mësipërm, duhet të sigurohet gjithëpërfshirja në aspektin përmbajtësor, duke punuar fillimisht në programin e shkollës dhe përcaktimin e kthinave të nevojshme varësisht nga kategoria e kërkesave dhe nevojave të veçanta.

C. Definimi i detajeve teknike

Bazuar në kërkesat e nxënësve me aftësi të kufizuara, duhet t'i kushtohet rëndësi fazës së projektit detaj dhe realizimit të objektit i cili do të përmbushte nevojat e të gjithëve, duke përfshirë këtu kushtet teknike të objektit, mobiliarin adekuat të përshtatur nga lloji i kërkesave, materialet e përshtatshme etj.

4.1. Qasja gjithëpërfshirëse dhe përshtatshmëria me nevojat speciale

Është shumë e rëndësishme që të arrihet dizajni i një shkolle me ambient të përshtatshëm dhe ftues, aty ku secili nxënës do të ndihej mirë dhe në përshtatshmëri maksimale me kërkesat e veta. Përpos rëndësisë së kurrikulës, angazhimit të stafit, ofrimit të asistencave adekuate, vetë dizajni i shkollës përbën njërin ndër komponentet kryesore të arritjes së gjithëpërfshirjes në shkolla.

Për dallim nga shkollat e rregullta, nxënësit me aftësi të kufizuara kanë kërkesa speciale të cilat duhet të mirren parasysh që në fazat fillestare të projektimit. Një qasje gjithëpërfshirëse nënkupton aplikim e tyre në mënyrë komplementare, pa i dhënë prioritet njëres kategori apo tjetres.

KËRKESAT E VEÇANTA

Mbështetja në procesin mësimorë - nxënësit mund të kenë nevojë për më shumë kohë në procesin e të kuptuarit dhe mësuarit. Kjo mund të arrihet duke e zvogëluar numrin e nxënësve në klasa, duke i grupuar në grupe më të vogla si dhe duke ofruar mësimëdhënës shtesë

Komunikimi me të tjerët - disa nxënës mund ta kenë më shumë te nevojshme diskutimin me të tjerët, komunikimin në grupe më të mëdha etj. Të tjerët mund ta kenë të nevojshëm komunikimin në hapësira më private dhe të qeta

Stimulimi shqisor - teknika të caktuara të komunikimit janë të nevojshme për nxënësit me shqisa të dëmtuara. Aplikimi i teknikave të zërit dhe dritës, pllakave taktile si dhe ndihma e specialistëve është e nevojshme

Ofrimi i terapisë - arrihet përmes ofrimit të llojit adekuat të terapisë varësisht nga nevoja, fizioterapisë, terapisë linguistike etj. Muzika, arti, performancat mund të llogariten si terapi shtesë, duke qenë te inkuadruara në kurrikulën shkollore

Mbështetja nga stafi mjekësor - nxënësit mund ta kenë të nevojshme ndihmën mjeksore, konsultat me stafin mjekësor, ndihmën e kohë pas kohshme etj. Hapësirat e dedikuara për këto kërkesa duhet të zëvendësojnë shërbimin ambulantor i cili mund të jetë në largësi të shkollës

Mobiliari adekuat - me qëllim të arritjes së efektivitetit në punë, është e nevojshme që të aplikohen teknika të caktuara, mobiliar adekuat i dimensionuar varësisht nga kërkesat e tyre speciale



Fig.14. Kthinat e veçanta në shkollat speciale: dhoma e relaksit, fizioterapia, klasa multifunkionale etj.

Shkolla gjithëpërshirëse shkon përtej principit: një dizajn i përshtatshëm për të gjithë! Është një objekt i cili merr në konsideratë kërkesat e të gjithëve, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për grupin në tërësi, por fillimisht për individët në veçanti. Ndër parametrat që duhet marrë parasysh janë:

Qasja

Një objekt i qasshëm u ofron nxënësve me aftësi të kufizuara mundësinë që të jenë pjesë e procesit mësimor dhe të gjitha aktivitetet e tjera përcjellëse. Rëndësi duhet t'i kushtohet:

- lokacion lehtë i qasshëm, me zgjidhje të thjeshtë dhe i kuptueshëm për të gjithë
- rrugë të qasshme për të gjithë, me gjerësi të mjaftueshme për personat në karrocë
- doreza të dyerve dhe rrethoja të arritshme për të gjithë
- rrugë e evakuimit e përshtatshme për të gjitha kategoritë e PAK

Hapësira

Nxënësit me aftësi të kufizuara kanë nevojë për më shumë hapësirë në mënyrë që të lëvizin lirshëm dhe të mund t'i përdorin paisjet e tyre speciale pa nevojën e të tjerëve. Për këtë arsye, gjatë fazës së dimensionimit shtesë, duhet të mendohet në:

- sigurimin e lëvizjes së lirshme me paisje mobiliteti në të gjitha hapësirat e shkollës
- sigurimin e lëvizjes përreth mobiliarit
- angazhimin e stafit shtesë për ndihmë atëherë kur është e nevojshme

Fleksibiliteti dhe adaptabiliteti

Shkolla gjithëpërfshirëse duhet të synoj të jetë adaptabile për nevojat e nxënësve të së tashmes dhe së ardhmës, duke qenë e përshtatshme për të gjitha fazat e shfrytëzimit dhe për të gjithë nxënësit me kërkesa të veçanta të cilët në një moment të caktuar do të vijnë në mësimin aty. Për tu arritur kjo është e rëndësishme që:

- hapësirat të jenë fleksibile dhe lehtë të adaptueshme varësisht nga kërkesat
- mobiliari të jetë i lëvizshëm dhe i përshtatshëm varësisht nga kërkesat, minimalisht të ketë prezencë të mobiliarit të palëvizshëm
- ndriqimi të jetë uniform dhe i përshtatshëm varësisht nga organizimi i hapësirave
- pozicionimi i shkallëve, liftit dhe bërthamave të servisimit të bëhet në atë mënyrë që të ofrojë mundësi të organizimit të hapësirave edhe në formacion tjetër në të ardhmen

Adaptimi shqisor

Me qëllim të përshtatshmërisë maksimale për nxënësit me dëmtim në shqisa të të parit apo të dëgjuarit, gjatë procesit të dizajnit duhet t'i kushtohet kujdes:

- elementeve të ndjeshmërisë - përdorimit të ngjyrave, dritës, zërit, teksturave dhe aromave
- aplikimit të akustikës së mirë me qëllim të lehtësimit të komunikimit për nxënësit me pengesa në komunikim
- aplikimit të materialeve dhe ngjyrave adekuate dhe krijimit të kontrasteve, me qëllim të lehtësimit të komunikimit në brendi të objektit dhe jasht tij

Rritja e efikasitetit në mësim

Një objekt mirë i dizajnuar do të përmirësonte efikasitetin në mësim, duke i ofruar mundësinë secilit nxënës që të përfshihet denjësisht në procesin mësimor, së bashku me nxënësit e tjerë. Në këtë aspekt, në procesin e dizajnit duhet t'i kushtohet rëndësi:

- nxënësit dhe mësimdhënësit të mund të komunikojnë lirshëm
- hapësirat për mësim dhe aktivitete të ndryshme të jenë lehtë të qasshme dhe me mundësi asistence shtesë
- mobiliari dhe pajisjet të jenë adekuate dhe të suportojnë teknika të ndryshme të mësimin
- nxënësit të kenë qasshmëri të lehtë deri te gjërat personale, toaletet, stafi mjekësorë dhe pajisjet e mobilitetit

Shëndeti dhe mirëqenja

Shkolla gjithëpërfshirëse duhet të promovojë shëndetin dhe mirëqenjen për të gjithë, duke krijuar një ambient të përshtatshëm për të gjitha nevojat e PAK. Kjo nënkupton ofrimin e ndihmës shtesë aty ku është e nevojshme, duke përfshirë këtu:

- kushtet e përshtatshme termike për të gjithë nxënësit
- ventilimin dhe cilësinë e ajrit të pastër
- izolimin nga zhurma dhe zërat që mund të shqetësojnë nxënësit
- ndihmën mjekësorë gjatë gjithë intervalit të qëndrimit të nxënësve në shkollë, sa herë që tu nevojitet
- ofrimin e ndihmës së parë dhe hospitalizim atëherë kur është e nevojshme
- mbajtjen e pastërtisë në nivel dhe largë infeksioneve të mundshme

Siguria

Të gjithë nxënësit është e nevojshme të ndihen të sigurtë dhe me mbështetje maksimale sa herë që u nevojitet. Gjatë fazës së dizajnit duhet të mirret parasysh:

- të ketë nivel të lartë të sigurisë, në kuadër të objektit dhe të rrethinës
- hyrjet dhe dalje të jenë të kontrolluara
- shenjëzimi të jetë adekuat dhe lehtë i kuptueshëm në mënyrë që nxënësit të mund të lëvizin edhe pa asistencën e të tjerëve
- të minimizohet rreziku nga lëndimet me mobiluar, dysheme, apo edhe pajisje të tjera



Fig.15 . Rëndësia në lëvizje dhe në qëndrim për nxënësit me aftësi të kufizuara

4.1. Trajtimi i lokacionit dhe rrethinës

Objekti shkollor duhet të ketë lokacion të përshtatshëm në relacion me përmbajtjet e tjera shoqërore në kuadër të qytetit apo fshatit, dhe lehtë i qasshëm për nxënësit me aftësi të kufizuara, prindërit, punonjësit social si dhe komuniteti në përgjithësi. Është e rëndësishme që të ketë lidhje të mira me transportin publik dhe mundësi që nxënësit me aftësi të kufizuara të vijnë pa përcjellje në shkollë. Preferohet që terreni të jetë i rrashtë, por edhe nëse ka lëvizje në kuota (disnivele), ato të menagjohen mirë, në mënyrë që të eliminohen maksimalisht shkallët dhe pengesat tjera fizike. Niveli i siguri duhet të jetë shumë i lartë, duke ofruar siguri për nxënësit dhe stafit gjatë kohës së shfrytëzimit të objektit. Me qëllim të mënjanimit të daljes së pakontrolluar të nxënësve me aftësi të kufizuara të cilët nuk mund ta perceptojnë rrezikun e trafikut në afërsi, rekomandohet që shkolla të jetë e rrethuar dhe e kontrolluar. Për dallim nga shkollat e rregullta, shkollat speciale kërkojnë numër më të madh të vendparkingjeve, duke marrë parasysh vizitat e shpeshta të prindërve, përcjellësve, nevojën për staf shtesë si dhe parkingjet e dimensionuara për PAK.

1. Rrethoja për sigurinë e objektit, 2. Gjelbërim i lartë dhe i ulët në periferi të lokacionit, 3. Klasët verore në pjesën e qetë të lokacionit, 4. Hapësirë për kultivimin e vegjetacionit, 5. Furnizimi, 6. Autobusi i shkollës, 7. Parkingjet, 8. Shtigjet e përshtatshme për levizje me karrocë, 9. Fushëlojat me dysheme të ngjeshur, 10. Kopshti, 11. Paisjet për lojë mirë të siguruara, 12. Zonë për lojëra të fëmijëve, 13. Strehë mbi hapësirën për hyrje dhe dalje, 14. Shesh për këmbësorë në hyrje, i ndarë nga rruga automobilistike, 15. Rrugë me qasje të lehtë për fëmijët e të gjitha kategorive




Fig.16 . Skema e organizimit të lokacionit

4.2. Qasja dhe komunikimi

Përpos afërsisë së përmbajtjeve në hapësirën publike përreth objektit, është e rëndësishme që edhe hapësirat funksionale brenda objektit të jenë në afërsi të njëra tjetrës dhe lehtë të qasshme. Është e rëndësishme që në afërsi të hyrjes të jetë recepcioni dhe pika informuese; hapësirat e shfrytëzuara nga prindërit dhe përcjellësit të jenë poashtu në afërsi të hyrjes; hapësirat të cilat shfrytëzohen nga komuniteti të jenë lehtë të identifikueshme por të ndara nga hapësirat për mësim dhe ato për ofrim të ndihmës mjekësore; sanitariet të jenë të llogaritura dhe të vendosura në distanca të përshtatshme për përdorim për të gjitha moshat; hapësirat e jashtme janë lehtë të arritshme; hapësirat për asistencë mjekësore të jenë poashtu

në afërsi të klasëve por të ndara nga ato etj. Rrugët e shkurta të komunikimit dhe hapësirat lehtë të identifikueshme, u lehtësojnë qëndrimin në objektin shkollorë nxënësve me aftësi të kufizuara, sidomos atyre me paisje të mobilitetit.

Një ndër aspektet më të rëndësishme të funksionimit të objektit shkollorë të përshtatshëm për PAK është çështja e hyrjes dhe daljes nga objekti shkollorë. Sheshi hyrës në afërsi të hyrjes duhet të jetë i gjerë, me mundësi parkimi të transportit special dhe prindërve (a,b). Rruga për këmbësorë deri te hyrja duhet të jetë e përshtatshme edhe për nxënësit me pengesa në të parë dhe e përcjellur nga pllakat taktore (c). Nga erëmbrojtësi e deri te holli hyrës, hapësira duhet të jetë lehtë e qasshme nga PAK dhe e monitorueshme nga stafi (d).



Fig.17. Organizimi i oborrit të shkollës

Lëvizja e nxënësve nga një hapësirë në tjetrën përveç efektit utilitar ka funksion edhe të aftësimit të tyre që të jenë të pavarur dhe të mund të funksionojnë në një mjedis të përbashkët me nxënësit e klasëve të rregullta. Për të ndihmuar rrugën e aftësimit të tyre, atyre mund tu ofrohen këto lehtësi në qasje dhe komunikim:

- ofrimi i mjeteve lëvizëse, mbajtësve përgjatë shtigjeve të brendshme dhe të jashtme, karrigeve lëvizëse apo edhe asistencën e stafit
- përdorimi i teknikës 'wayfinding', shenjave, ngjyrave, simboleve, tingujve dhe objekteve referuese identifikimi të cilat do tu ndihmonin në orientim
- përdorimi i pllakave taktile dhe ngjitësve me ngjyrë në dysheme

Në dizajnimin e hapërisave për komunikim duhet të kushtohet kujdes në parametrave të caktuar varësisht se ku ndodh lëvizja, në ambiente të jashtme, apo brenda në objekt. Për hapësirat e jashtme është e rëndësishme që objekti të ketë:

- dyer të gjera dhe doreza të arritshme
- vende për ulje në distance prej 5 metrash në rast nevojë për pushim
- materiale të përshtatshme të shtigjeve me qëllim të lëvizjes së lehtë me karrocë dhe mjete të tjera të mobilitetit
- të gjitha hapësirat lehtë të monitorueshme nga stafi përcjellës
- hapësirat e zhurmshme të distancuara nga hapësirat e qeta me qëllim që secili fëmijë t'i shfrytëzoj kthinat më të përshtatshme për ta

- shtigje të gjera për lëvizje, të pa pengua nga hapja e dyerve apo e dritareve (120cm deri në 180 cm)

Komunikimi në hapësirat e brendshme të shkollës kërkon më shumë sipërfaqe, për arsye se nxënësit me aftësi të kufizuara kërkojnë më shumë hapësirë në mes njëri tjetrit dhe shoqëruesve të tyre si dhe paisjet e mobilitetit të cilat mund t'i kenë nën shfrytëzim konsumojnë sipërfaqe të mëdha. Poashtu nxënësit të cilët kanë pengesa shqisore kërkojnë hapësirë të veçantë orientuese. Këtyre hapësirave duhet tu shtohet edhe sipërfaqja e zënë me mbajtëset anësore të cilat shërbejnë për një komunikim më të lehtë.


Hapësira minimale për komunikim në korridoret e brendshme duhet të jetë 180 cm, e përshtatshme për lëvizjen e dy personave me karrocë, ndërsa gjerësi e pastër prej 200 cm preferohet në korridoret të cilat dërgojnë në më shumë se dy ose tri klasa. Organizimi praktik prodhon hapësira komunikuese të qarta për lëvizjen e PAK, duke mënjanuar konfuzitetin dhe rrezikun në raste evakuimi.

Hapësirat e komunikatës horizontale, korridoreve, duhet të jenë mirë të ndriçuara, mirë të ajrosura. Ato duhet të jenë hapësira inkurajuese, shpesh hapësira ekspozuese të punës kreative të fëmijëve. Preferohet që të kenë lojë ngjyrash dhe teksturash me qëllim të orientimit sa më të mirë.

Në hapësirat komunikuese të objektit shkollor zë pjesë edhe pika informuese, e cila para së gjithash duhet të jetë atraktive dhe ftuese për të gjithë nxënësit, pa dallim. Ajo duhet të jetë e realizuar me materiale të ngrohta dhe me sa më shumë ekspozime të punëve të nxënësve, me qëllim të rritjes së vetbesimit të nxënësit për arritjet e tyre. Kjo hapësirë duhet të jetë mirë e menaxhueshme sa i përket ndriçimit, me qëllim të ruajtjes së bilancit në mes hapësirës së jashtme dhe asaj të brendshme.

Në dizajnimin e kësaj hapësirë, rëndësi duhet t'i kushtohet:

- të jetë një hapësirë mirë e definuar, e qasshme për të gjithë dhe lehtë e kontrolluar nga stafi, duke rritur sigurinë në objekt (a)
- të jetë e paisur me tavolinë informuese e orientuar nga holli hyrës, e lartësisë së përshtatshme edhe për nxënësit me karrocë (b)



- të ketë hapësira të mjaftueshme për ulje dhe pritje, të dimensionuara edhe për nxënësit me karrocë (c)
- të ketë hapësira për pozicionimin e karrocave dhe mjeteve për mobilitet (d)
- të ketë toaleta të qasshme për PAK në afërsi (e)
- të jetë një hapësirë e dedikuar për prindërit në afërsi (f)

Fig.18. Organizimi i hollit hyrës dhe receptionit

4.3. Organizimi i njësive dhe parametrat e rëndësishëm gjatë projektimit të tyre

Shkolla gjithëpërfshirëse e cila u dedikohet të gjithë nxënësve pa dallim, është më komplekse se sa objektet shkollore të klasëve mësimore të rregullta. Duke patur për njësi themelore klasën ku zhvillohet mësimi, shkolla gjithëpërfshirëse përbëhet edhe nga hapësira të tjera përcjellëse, duke përfshirë këtu klasët për grupe më të vogla, klasët për kujdes ditorë, hapësira për rekreim dhe sporte, hapësirat për terapi ditore, kthinat për art dhe muzikë, bibliotekën, lojërat në të hapur etj. Me qëllim të arritshmërisë në mësimnxënje, punonjësit social rekomandojnë fleksibilitet maksimal dhe laryshi përmbajtjesh në aktivitetet ditore të nxënësve me aftësi të kufizuara.



Fig.19. Aktivitetet e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat speciale

KTHINAT PËR MËSIM - KLASËT

Mësimi zhvillohet në klasë të grupeve të vogla në prani të mësueses apo arsimtarëve dhe në raste të caktuara me ndihmë të asistentëve. Në kuadër të hapësirave mësimore, shkolla duhet të ketë:

- klasa të ndara në grupe të caktuara nxënësish
- kthinat për aktivitete përcjellëse
- kthinat për punë individuale apo në grupe të vogla
- bibliotekën dhe hapësirën për shfrytëzimin e kompjuterëve
- hapësirën për shumë qëllime, me mundësi të qasjes edhe nga ana e komunitetit në raste të performancave të caktuara
- klasët verore me mundësi të zhvillimit të orëve mësimore dhe aktiviteteve përcjellëse në ambiente të hapura

Kthinat e mësimit janë të përcjellura nga këto përmbajtje përcjellëse:

- sallën e arsimtarëve dhe zyren e drejtorisë
- toaletet të ndara në gjini dhe të qasshme për të gjithë
- kuzhinën dhe tryezarinë
- depo dhe kthinat për mirëmbajtje

Klasët dimensionohen për qasshmëri të plotë nga personat me përdorim të karrocës, gjë që rrit sipërfaqen e përgjithshme të një klase deri në 70 m². Numri i mobiliarit statik minimizohet, duke i lënë vend mobiliarit fleksibil dhe mundësisë së organizimit të klasave në tipe të ndryshme (Tipi A, B, C dhe D). Dërrasa e zezë për shkrim vendoset në lartësi të qasshme nga PAK. Të gjitha klasat kanë dalje direkte në ambient të



1. Tavalina e mësues-es/it 1800x700x720 , 2. Tabelë dhe projektor, 3. Tabelë për shënime 600 x 900, 4. Raftë për libra dhe material hulumtues, 5. Lavaman, 6. Hapësirë për organizim në grupe

Fig.20. Tipologji të organizimit të klasës amë

jashtëm, në drejtim të klasëve verore. Këto tipologji organizimi ofrojnë mundësi për organizim të grupeve më të vogla të mësimit, dhe mundësi të lëvizjës edhe nga mësuesdhënësi që mund të jetë poashtu person me aftësi të kufizuara.

KLASËT PËRCJELLËSE DHE KUJDESI DITORË

Për arsye të natyrës me sensitive të bashkëpunimit me këto grupmosha, paraqitet nevoja e organizimit të klasëve dhe mësimit shtesë në grupe më të vogla, 6-8 nxënësish, në ambiente më fleksibile se sa klasët e zakonshme. Këto kthina mund të shfrytëzohen edhe pas përfundimit të mësimit ditor në klasët e rregullta, në formë të qëndrimit ditorë, përfundimit të obligimeve ditore si dhe aftësimit në lëmi të caktuara.




Fig.21. Organizimi i qëndrimit ditorë, i preferuar për grupmosha më të vogla

1. Hapësira për zhvillimin e aktiviteteve, 2. Tavolinë lëvizëse (përshtatje në lartësi), 3. Tabelë për projektor, 4. Këndi për relaks, 5. Këndi 'sensor', 6. Tavolina e mësuesi, 7. lavaman lëvizës (përshtatje në lartësi), 8. Dhoma për konsultime, 9. Depo, 10. Hapësirë për karroca

HAPËSIRA PËR SHUMË QËLLIME

Pozicionimi i hapësirës për shumë qëllime bëhet në afërsi të hollit hyrës, me qëllim të qasjes më të lehtë edhe për komunitetin. E tërë kjo hapësirë është lirshëm e organizuar, pa mobiliar fiks, dhe me mundësi të ndarjes në 2-3 hapësira të tjera më të vogla, varësisht nga natyra e aktiviteteve të zhvilluara aty.

Në kuadër të hapësirës për shumë qëllime apo si kthinë e veçantë mund të paraqitet hapësira për muzikë. Instrumentet muzikore mund të përshtaten në atë mënyrë që të jenë të përdorshme edhe nga fëmijët me pengesa fizike, ndërsa muzika rekomandohet të jetë pjesë e kurrikulës me qëllim të aplikimit të terapevite të ndryshme muzikore dhe përmirësimit të gjendjes së PAK. Hapësira për muzikë mund të shërbejë edhe për shfaqje të ndryshme teatrale, me kushtin që të ketë akustikë të mirë dhe të jetë afërsisht 55-65 m².



Fig.22. Shembuj të organizimit të hapësirës për shumë qëllime

BIBLOTEKA

Një komponentë shumë e rëndësishme e rritjes së efikasitetit në mësim, është prania e një biblioteke të pasur dhe mirë të organizuar. Së bashku me librat e ekspozuar dhe mobiliarin e lëvizshëm (tavolinat me mundësi ngritjeje dhe ulje varësisht nga nevoja e nxënësve), është e rëndësishme që nxënësit me aftësi të kufizuara të mund ta përdorin edhe teknologjinë në këtë ambient, duke u nisur nga kompjuterët, sistemin Braille, ekranet 'touch', spjegimet audio dhe video vizuale. I gjithë sistemi i kërkimit

duhet të jetë në nivelin e shfrytëzimit me karrocë. Përpos uljes formale, biblioteka është mirë që të ketë mundësi të uljes në karrige më fleksibile, fotele amorge etj. Biblioteka është e rëndësishme që të lidhet me hollin hyrës dhe të jetë lehtë e qasshme.




Fig.23 . Shembuj të shërbimit të bibliotekës për të gjitha kategoritë e PAK

TRYEZARIA DHE KUZHINA

Shujtat e përbashkëta ndikojnë pozitivisht në nxënësit me aftësi të kufizuara, duke krijuar te ta ndjenjën e gjithëpërfshirjes dhe duke ngritur vetëbesimin. Varësisht nga kategoria, disa nxënës mund të kërkojnë më shumë kohë për përfundimin e shujtave, disa mund të kërkojnë asistencë, e të tjerët mund të kenë si kërkesë të distancohen për tu ushqyer në qetësi. Tryezaria e përbashkët duhet të jetë e dizajnuar në atë mënyrë që tu ofrojë secilit mundësinë të udhëqehen pa përcjellës, duke patur qasje në të gjitha tavolinat, në banakun e shërbimit dhe duke patur mundësi ta shohin ushqimin e servuar. Është e rëndësishme që kjo hapësirë të mos jetë shumë e ngjeshur në organizim dhe të mos krijoj stres te nxënësit. Kuzhina është direkt e lidhur me tryezari, dhe mund të dimensionohet në atë mënyrë që nxënësit të mund të inkuadrohen në pregaditjen e shujtave. Disa fëmijë për shkak të pengesave që kanë, mund të kenë kërkesa për menu tjetër nga masa, vaesisht nga dietat e tyre mjekësore.



Fig.23 . Shembuj të organizimit të tryezarisë të përshtatshme për PAK

PALESTRA SPORTIVE

Edukata fizike konsiderohet të jetë shumë e rëndësishme për fëmijët me aftësi të kufizuara. Në kurrikulën mësimore ajo zë vend të posaqëm me qëllim të vuarjes në funksion të zhvillimit fizik të tyre, rritjen e mobilitetit dhe pavarësimin e tyre në lëvizje. Për këtë arsye salla e edukatës fizike rekomandohet të jetë e dizajnuar në përshtatshmëri maksimale për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në mënyrë që ata të ndihen mirë në një ambient të përshtatshëm për nevojat e tyre dhe të inkurajohen sa më shumë që të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme fizike.



Fig.24 . Shfrytëzimi i palestrës sportive nga PAK

Palestra sportive rekomandohet të jetë e lidhur edhe me fushëlojat në të hapur. Ajo duhet të jetë e përshtatshme për të gjitha moshat, dhe pa objekte të cilat mund të shkaktojnë lëndime. Materialet e dyshemesë dhe të mureve duhet të jenë të finalizuara mirë, duke mënjanuar mundësinë e aksidenteve. Dyshemeja rekomandohet të jetë pa shkëlqim, ndërsa akustika në nivel të duhur. Poashtu shenjëzimi është i rëndësishëm.

SIPËRFAQET E HAPURA

Sipërfaqet e jashtme mirë të trajtuara kanë probabilitet të rrisin efektivitetin në mësim, rritjen e vullnetit për punë dhe për tu bërë pjesë e procesit mësimorë si dhe ndikojnë në pavarësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe socializimin e tyre me të tjerët. Në këto sipërfaqe bëjnë pjesë:

- klasët verore në të cilat zhvillohet një pjesë e mësimi
- fushëlojat në të hapur të cilat janë të lidhura me palestrën sportive
- hapësirat informale për rekreim, pushim dhe lojë



Fig.25. Shembuj të organizimit të sipërfaqeve të hapura të përshtatshme për PAK

Klasët verore konsiderohen njëlloj sikurse klasët amë, por që kanë për qëllim bartjen e disa njësive mësimore në natyrë, atëherë kur kushtet klimatike e mundësojnë një gjë të tillë. Rëndom janë pjesërisht të mbuluara, dhe me qasje direkte nga klasa amë. Fushëlojat janë të trajtuara me bari artificial dhe të përcjellura me lojëra të cilat kanë dysheme të ngjeshur dhe të përshtatshme për lojë për të gjitha stinët. Edhe nxënësit me pengesa fizike duhet të ndihen konfident në shfrytëzimin e lojërave, pa mundësi lëndimi apo rrëshqitjeje.

Hapësirat informale për socializim rekomandohet të jenë të dizajnit të thjeshtë, me ulëse të shpërndara në vende të qeta dhe të zhurmshme, duke marrë parasysh natyrën komplekse të këtyre fëmijëve dhe nevojën për të gjetur veten në vendin më të përshtatshëm.

4.4. Përmbajtjet përcjellëse

Për arsye të nevojave kërkesave të veçanta të nxënësve me aftësi të kufizuara, objekti shkollor i dedikuar për ta duhet të ketë edhe përmbajtje përcjellëse ku bëjnë pjesë: kthinat për trajtim mjekësorë, kthinat e stafit mjekësor dhe asistentëve, toaletet e veçanta dhe depot e materialeve shpenzuese dhe inventarit.

Ndër përmbajtjet me sipërfaqe më të mëdha janë kthinat për trajtim mjekësorë, duke qenë se varësisht nga kategoria të cilës nxënësit i takojnë, ata kanë nevojë për një numër të madh të stafit mjekësorë mbikqyrës : • motra medicinale, • mjeku, • fizioterapeuti, • punëtorët social, • psikologu, • këshilluesit, • psikiatri etj.

DHOMA E MJEKUT

Kthina për shërbime mjekësore mund të jetë 15-25 m². Ajo mund të shërbejë edhe për fizioterapi. Duhet të ketë mobiliar të kompletuar dhe mundësi për pushim pasi që pacienti/nxënësi të ketë marrë ndihmën. Duhet të jetë e ventiluar mirë dhe e mirëmbajtur sa i takon higjienës.

FIZIOTERAPIA

Kjo kthinë arrinë sipërfaqen deri në 25-30m². Duhet të jetë e paisur me të gjitha piasjet fizioterapeutike dhe një shtrat mjekësorë të dimensioneve minimale 900x1800mm. Muret dhe dyshemeja duhet të suportojnë tronditjet nga ushtrimet ditore, si dhe të jenë të realizuara me tekstura në kontrast. Hapësira lëvizese nga njëra piasje në tjetrën duhet të jetë e mjaftueshme për lëvizje me karrocë.

LOGOPEDIA

Në sipërfaqen prej 12-25 m² nevojitet të organizohet hapësira e punës së logopedit e përbërë nga tavolina e punës, një pasqyre për ushtrimin e të artikuluarit në të folur, një mur i lirë për projektimin e inqizimeve audio-vizuele, dollapi për vendosjen e paisjeve speciale si dhe një lavaman. Kthina duhet të jetë me ndriqim natyrorë dhe e ventiluar mirë. Është shumë e rëndësishme që të ketë izolim akustik të mirë.



Fig.26. Organizimi i kthinës së mjekut



Fig.26. Hapësira për fizioterapi



Fig.26. Organizimi i kthinës së logopedit

STUDIO E 'SENSORËVE'

Dhoma për përmirësimin e ndjeshmërisë shqisore shërben për një nxënës e deri në grupe të vogla nxënësish. Rëndom është një hapësirë tërësisht e bardhë apo e zezë, me pajisje elektronike të cilat prodhojnë spektër të gjerë ngjyra në formë të dritës intensive. Sipërfaqja e saj varion nga 24-35 m². Materialet e dyshemesë dhe të mureve janë të lëmuara, me kënde të finalizuara mirë.



Fig.27. Menyra e funksionimit të studios së 'sensorëve'

HIDROTERAPIA

Hidroterapia është e përfshirë në objektet shkollore të PAK me qëllim të ofrimit të tretmaneve teraupetike në ujë të nxehtë dhe mineral për personat me dëmtime fizike. Kjo terapi u ndihmon PAK në relaksim, zhvillim të muskujve, qëndrueshmëri më të madhe etj. Rëndom terapitë zhvillohen në mes të terapeutit dhe një nxënësi, apo edhe në grupe vogla.




Fig.28. Shembuj të pishinave terapeutike

Parametrat e rëndësishëm gjatë projektimit të pishinës terapeutike në kuadër të shkollës janë:

- sipërfaqja minimale 85 m²
- sipërfaqja minimale e pishinës 24 m²
- hapësira e lirë përreth pishinës për siguri në lëvizje 2-2.5 m
- garderobat për nxënës 30 m² për secilën gjini
- garderobat për staf 4-6 m²
- hapësirat teknike minimale 20 m²

Për pishinën me ujë të nxehtë me sipërfaqe 72 m² kërkohet sipërfaqe e përgjithshme afërsisht 144 m². Për te dyja rastet kërkohet që pishina të jetë e qasshme për personat me aftësi të kufizuara, posaqërisht përdoruesit e karrocës. Në pishinat e projektuara nga fillimi aplikohet pjerrina me zhytje graduale në ujë e cila është e përshtatshme për lëvizje të pavarur të personit në karrocë (5%-8%), ndërsa për pishinat ekzistuese shfrytëzohen pajisjet mekanike të cilat ndihmojnë në zhytjen e personit në pishinë.




Fig.29. Shembuj të qasjes në pishinë: (a) përmes pjerrinës, (b) në menyre mekanike




Fig.30. Skema e pjerrinës së pishinës




Fig.30. Toaleti dhe dush kabina për PAK

Element i rëndësishëm në trajtimin e pishinës gjithëpërfshirëse është edhe dimensionimi i sanitarieve, tushave dhe garderobave për persona me aftësi të kufizuara.

TOALETET

Toaletet për personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një prej përmbajtjeve më komplekse sa i përket specifikave të organizimit. Disa nga tipet e organizimit të tyre janë dhënë në skemat e mëposhtme (a-c). Është shumë e rëndësishme që përveç hapësirës lëvizëse të personit me karrocë të lihet hapësirë e mjaftueshme e një personi tjetër i cili mund ta asistojnë nxënësin me aftësi të kufizuara në momentin që ai kërkon ndihmë përmes alarmit të instaluar në secilën kabinë. Lartësia e elementeve duhet t'i përshtatet moshës së fëmijut, duke qenë se për grupmoshat më të vogla kërkohen lartësi më e ulët dhe e anasjellta. Në të gjitha rastet dorëza lëvizëse duhet të jetë mirë e pozicionuar me qëllim të mundësitë të largimit të paisjes së mobilitetit/ karrocës dhe ofrimit të saj kur është e nevojshme.




Fig.31. Tipologji të organizimit të toaleteve në bjektet shkollore: (a) në rastet kur nuk shfrytëzohen paisjet e mobilitetit, (b) dhe (c) kur shfrytëzohen paisjet e mobilitetit

Skema e mëposhtme tregon lartësitë e aplikueshme për fëmijët e objekteve parashkollore (a) dhe për nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme (b).



Fig.32. Lartësitë e aplikueshme në guacën e toaletit varësisht nga moshë e fëmijëve

4.5. Atributet teknike

Përcaktimi i detajeve teknike përbën fazën më të rëndësishme të funksionimit të objektit shkollor gjithëpërfshirës. Fëmijët me aftësi të kufizuara, për shkak të kompleksitetit të situatave me të cilat përballen çdo ditë, tregojnë ndjeshmëri të madhe në ambientet e mbyllura, varësisht nga materialet e zgjedhura, teknikat e hapjes së dyerve dhe dritareve, mënyrës së funksionimit të ngrohjes dhe klimatizimit etj. Ndër elementet që nuk duhet shmangur gjatë fazës së projektimit janë këto:

Qëndrueshmëria

Marrë në konsideratë qarkullimin e karrocave dhe mjeteve tjera të mobilitetit të shfrytëzuara nga PAK, është e rëndësishme që të parashihen dëmet eventuale sidomos në dritaret, dyert dhe muret e objektit (deri në lartësinë 30-40cm). Materialet e aplikuar në këto tri elemente duhet të jenë mjaftueshëm të qëndrueshme dhe me mundësi reparimi.

Thjeshtësia

Rekomandohet që objektet e dedikuara edhe për nxënësit me aftësi të kufizuara të jenë skajshmërisht të thjeshta. Disa fëmijë mund të pengohen apo shpërqëndrohen nga detajet.

Higjiena

Është shumë e rëndësishme që niveli i pastërtisë në këto objekte të jetë shumë i lartë, marrë në konsideratë edhe shëndetin më të luhatshëm për disa nga kategoritë e PAK. Duhet të eliminohen hapësirat që nuk mund të pastrohen lehtë apo krijojnë probleme në mirëmbajtje.

Siguria

Elementet standarde të apikuara në të gjitha shkollat, mund të mos mjaftojnë për sigurinë e nxënësve me aftësi të kufizuara. Këndet dhe teksturat e forta mund të shfaqin lëndime në lëvizjen e tyre të përditshme, prandaj duhet kushtuar kujdes në çdo detaj gjatë fazës së projektit zbatues së objektit të shkollës gjithëpërfshirëse.

5.0. VIZIONIMI I OBEKTIT SHKOLLOR DHE REHABILITUES 'SHKOLLA PËR TË GJITHË'

Vizionimi i shkollës gjithëpërfshirëse 'Shkolla për të gjithë' është produkt i punëtorisë së mbajtur me nxenesit me aftësi të kufizuara, prindërit e tyre dhe nxënësit e klasave të rregullta. Edhe pse e inicuar vetëm për ideimin e një objektit shkollorë më të përshtatshëm se sa shkollat ekzistuese, nxënësit kanë shprehur dëshirën që të mendohet edhe për një aspekt tjetër, atë të mirëqenjes. Për këtë arsye, dalë nga punësoria, ky vizionim ka për produkt dizajnimi e objektit shkollorë i cili ngërthen në vete edhe hapësirat tjera shtesë që lidhen me shëndetin e PAK, kujdesin ditorë për ta, rekreimin dhe aktivitetet sportive si dhe terapitë e ndryshme.



Fig.33. Skema - Objekti shkollor dhe rehabilitues 'Shkolla për të gjithë'

Kërkesat e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre për të patur në kuadër të objektit shkollor edhe njësitë për kujdesin mjekësorë ditor, hidroterapinë, ndihmën e psikologut dhe punonjësve social, arsyetohet edhe me rastet e studimit të përfshira në kuadër të këtij hulumimi. Prandaj rezultati i punëtorisë për vizionimin e shkollës gjithëpërfshirëse është projekti konceptual për *Objektin Shkollor dhe Rehabilitues 'Shkolla për të gjithë'*.

5.1. Koncepti

Koncepti i shkollës gjithëpërfshirëse është para së gjithash i bazuar në rrëfimet personale të pjesëmarrësve të punëtorisë dhe nevojës së tyre të pa kontestueshme për tu bërë pjesë e një institucioni arsimor. Një vendi ku ata do të ndiheshin si në shtëpinë e tyre, por do të plotësoheshin intelektualisht dhe shpirtërisht përmes interaksionit me femijët e tjerë të klasave të rregullta.

Bazuar në ecurinë e punëtorisë dhe propozimin e përmbajtjeve funksionale të shkollës gjithëpërfshirëse, ky objekt do të mund të kategorizohej në tri sektorë: objekti shkollor me përmbajtje klasë, tyezinë, kuzhinën dhe kthinat e mësimdhënësve, objekti rekreues dhe rehabilitues me përmbajtje: sallën sportive, pishinën terapeutike si dhe kujdesi ditor dhe shëndetësia me përmbajtje: kthinat e mjekut kujdestarë dhe fizioterapeutit, sallën multifunksionale/kinemanë, kthinën për muzikë, qëndrimin ditor si dhe bibliotekën.

Rrjedhimisht, koncepti për 'Shkollën për të gjithë' synon arritjen e një modeli të shkollës gjithëpërfshirëse, e cila është prototip i një shtëpie (apo i shumë shtëpive), të cilat të shtrira në lokacion, ngërthejnë në vete të gjitha përmbajtjet funksionale të parashtruara si kërkesë e pjesëmarrësve të punëtorisë, dhe të përkthyer në gjuhë

arkitektonike. Shtëpitë e vendosura në varg figurativisht tentojnë që të krijojnë ndjenjën e të qëndruarit 'si në shtëpi' për secilin fëmijë, përderisa të grupuara në sektore ato determinojnë ndarjen funksionale të tërë objektit në kategori përmbajtjesh të kërkuara nga pjesëmarrësit.

Duke patur si kërkesë të veçantë praninë e hapësirave gjelbëruese përreth objektit dhe në brendësi të tij, oborri i brendshëm dhe gjelbërimi zë vend të veçantë në konceptin e 'Shkollës për të gjithë'. Me pozicionimin e tij në qendër, tri përmbajtjet e kërkuara nga pjesëmarrësit e kufizojnë atë, duke dhënë mundësi që gjatë tërë lëvizjes nga njëra përmbajtje në tjetrën, hapësira gjelbëruese të përjetohet dhe të njëjtën kohë të shfrytëzohet lehtësisht.

Të gjitha përmbajtjet funksionale të objektit zhvillohet në përdhësë, duke bërë që objekti të zhvillohet vetëm në horizontale. Mënjanimi i disniveleve krijon siguri dhe lehtësi në lëvizje për nxënësit me aftësi të kufizuara, ndërsa në fasadë prodhon një objekt të qetë dhe pa lëvizje të mëdha në volumetri. Si i tillë objekti shtrihet në terren, duke u mëshiruar me hapësirën gjelbëruese brenda dhe jashtë tij, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më miqësor për të gjithë.




Fig.34. Zhvillimi i konceptit të objektit shkollor dhe rehabilitues 'Shkolla për të gjithë'



Fig.35. Imazh i eksterierit të objektit 'Shkolla për të gjithë'

5.2. Shtrirja funksionale dhe përshkrimi i projektit

Objekti shkollor dhe rehabilitues 'Shkolla për të gjithë' shtrihet përreth oborrit të brendshëm, i ndarë në segmente të veçanta varësisht nga funksioni (objektet e veçanta sipas punëtorisë). Duke qenë se ky projekt paraqet vetëm zgjidhjen konceptuale, objekti është idealizuar të jetë me vend ndodhje në një hapësirë të qetë, të distancuar nga trafiku i dendur, por në të njejtën kohë afër indit urban dhe objekteve kryesore publike. Qasja në lokacion është menduar të bëhet përmes rrugës së banimit, ndërsa objekti shkollor të jetë i rrethuar duke patur parasysh sigurinë e nxënësve. Hyrja për një objekt realizohet përmes një hapësirë të pllakëzuar, e cila ka funksion edhe të mbledhjes së një grupi më të madh të nxënësve në situata të caktuara. Hyrja në objekt realizohet përmes shkallëve dhe pjerrinës, e cila është e dizajnuar sipas normativave, me ramje 5 % dhe me dorezë me përfundim të rrumbullakët, e cila është e lartësisë 90 cm. Në lartësinë +60 cm kufizohet me një ndarje horizontale, ndërsa në +90 cm me ndarjen e dytë horizontale.

Në anën e majtë të objektit është lënë hapësirë e nevojshme për zhvillimin e vendpikëringjeve, pjesa e konsiderueshme e të cilave është dedikuar për personat me aftësi të kufizuara. Gjerësia për një vendparking është paraparë të jetë 220 cm, ndërsa në afërsi janë lënë në dispozicion edhe 150 cm për lëvizjen e personit me karrocë gjatë hyrjes dhe daljes në automjet.

Shtigje të qasshme për persona në karrocë janë të projektuara përreth gjithë lokacio -

-nit, ndërsa hapësirat gjelbëruese janë më të intensifikuara në ato pjesë të lokacionit në të cilat është paraparë qëndrimi dhe socializimi.

Shtritja e përmbajtjeve kryesore, klasëve, është bërë në anën jugore të objektit, përdërisa pishina ka orientim në jug dhe në lindje. Palestra sportive është e orientuar veri-jug, ndërsa kthinat tjera ndihmëse në veri. Partia hyrëse së bashku me bibliotekën janë të orientuara në perëndim.

Në anën lindore janë të zhvilluara fushëlojat në të hapur, pishina e hapur dhe lojërat për fëmijë më të vegjël. Pishina është e lidhur me grupacionin e garderobave të pishinës së mbyllur.




Fig.36. Përshkrimi i zgjidhjes së lokacionit 'Shkolla për të gjithë'

Nga aspekti funksional, objekti shkollor dhe rehabilitues 'Shkolla për të gjithë' është konceptuar në atë mënyrë që të jetë lehtë e qasshme dhe e shfrytëzueshme nga të gjitha kategoritë e PAK. Ndarja funksionale zhvillohet në katër segmente, duke mundësuar shfrytëzimin e tyre në periudha të ndryshme të ditës, dhe duke mos ndërferuar në punën që është duke u zhvilluar në njërin nga segmentet (krahët e objektit).

Hyrja është e definuar qartë, me vizura nga oborri i brendshëm, duke e rritur transparencën dhe mundësinë e orientimit të mirë për nxënësit me aftësi të kufizuara. Në anën e majtë të hyrjes ndodhe recepcioni i qasshëm për PAK, ndërsa përballë hyrjes është dizajnuar kthina e prindërve. Menjeherë në të djathtë është organizuar filter garderoba e cila u mundëson nxënësve që të vendosin gjërat personale. Klasët, si njësi amë e këtij objekti, janë të vendosura në anën jugore dhe më së afërmi hyrjes. Ato janë të organizuara në mënyrë që të shërbejnë për të gjitha kategoritë e PAK dhe arrijnë sipërfaqen prej 75 m². Mobiliari është i lëvizshëm dhe e gjithë hapësira është e qasshme për persona me karroca. Klasët lidhen me hapësirën e jashtme, klasët verore,

ku mendohet që të zhvillohet një pjesë e mësimit atëherë kur premtojnë kushtet atmosferike.

Menjëherë pas klasëve, me kërkesë të pjesëmarrësve të punëtorisë, është menduar të jetë tryezaria e lidhur me kuzhinë. Në rastin konkret, si ide e dalë nga punëtorja, kuzhina është menduar të jetë e shfrytëzuar edhe nga prindërit e nxënësve, të cilët do të asistojnë në pregaditjen e shujtave. Kjo ka rritur sipërfaqen e kuzhinës në 65 m² ndërsa tryezaria arrin sipërfaqen prej 110 m².

Në mes të klasëve dhe kantinës është pozicionuar grupacioni i parë i toaleteve, të cilat janë të ndara në gjini, dhe të dizajnuara varësisht nga nevojat e veçanta të nxënësve. Toaletet për përdoruesit e karrocave janë të dimensioneve 225 x 225 cm, të dizajnuara me guacë me mbështetës në të dy anët, lavaman, alarm dhe hapësirë të mjaftueshme të kthimit të personit në karrocë.

Këto përmbajtje përmbyllin segmentin e 'objektit të shkollës', praktikisht segmentit në të cilin zhvillohet pjesa e parë e ditës. Pas mësimit obligativ, bazuar në kërkesën e nxënësve pjesëmarrës në punëtori, në shkollën gjithëpërfshirëse nxënësit mund të vazhdojnë me aktivitete përcjellëse. Në këtë mënyrë pas përfundimit të sektorit të parë, përmes korridorit me vizura nga oborri i brendshëm vazhdohet në sektorin e dytë, atë të rekreimit dhe rehabilitimit. Ky sektor përbëhet nga pishina e mbyllur dhe palestra, të cilat ndahen dhe bashkohen në mes vete përmes korridorit të pa pastër, i cili dërgon në garderobat e veçanta për secilën përmbajtje.

Pishina e cila është më e ndjeshme sa i takon higjienës, është e izoluar nga hapësira e jashtme përmes grupacionit të sanitarieve dhe dush kabinave, të gjitha të dimensionuara për PAK në bazë të Udhëzuesit Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara. Garderobat janë ndërruese-kaluese, ku personi vishet me rroba banjoje, kalon nga dush kabina, dhe përmes korridorit të pastër depërton në zonën e pishinave terapeutike. Sipërfaqja e pishinës arrin 346 m².





Fig.37. Ndarja e segmenteve funksionale në kuadër të objektit

Palestra është dhënë në dimensionet 1524 x 2560 cm me hapësirë qarkullimi përreth prej 150 cm, të mjaftueshme për një person në lëvizje me karrocë. Edhe kjo përmbajtje paraprihet nga garderobat e ndara në gjini, të cilat poashtu janë të dizajnuara për nevojat e PAK. Korridori i pastër dhe i pa pastër janë dhënë në gjerësi 150 cm, duke u dhënë personave me karrocë mundësi të lehtë kthimi.

Përpos hapësirës për sport dhe rekreim, në dy segmentet tjera kemi shtrirje funksionale të ndryshme. Në segmentin e tretë, apo të dytin nga e djathta nëse nisemi nga hyrja, zhvillohet grupacioni i shërbimeve shëndetësore, të prioritizuara nga nxënësit me aftësi të kufizuara në punëtori. Këtë grupacion e degazhon korridori i përbashkët, i cili dërgon në kthinën e terapeutit (17 m²), psikologut (13 m²), infermieres (16 m²) dhe mjekut (16 m²). Në kthinën e psikologut është menduar të organizohet edhe puna e logopedit në rastë nevojë, ndërsa në kthinën e infermieres është menduar të jetë edhe një shtrat për hospitalizim për rastet më të lehta apo deri në arritjen e ndihmës së parë. Kthina për shërbime mjekësore qëndron në mes të palestrës sportive dhe pishinës në njërën anë, dhe kujdesit ditor dhe klasëve në anën tjetër. Kjo qëllimisht që tu ofrohet në shpejtësi ndihma e nevojshme nxënësve të cilët janë duke shftrëzuar njërin segment apo segmentin tjetër të objektit.



1. Hyrja, 2. Filter garderoba, 3. Klasë, 4. Klasë verore, 5. Këndi i prindërve, 6. Toaleta, 7. Kuzhina, 8. Tryezaria, 9. Pishina terapeutike, 10. Garderobat e pishinës terapeutike, 11. Garderobat e palestrës, 12. Kthina e trajnerëve, 13. Kujdesi ditor, 14. Kthina e muzikës, 15. Fizioterapeuti, 16. Psikologu dhe Logopedi, 18. Ndihmësja e mjekut, 19. Mjeku, 20. Kthina e asimtarëve, 21. Kthina e edukatoreve, 22. Drejtoria, 23. Salla multifunksionale, 24. Bibloteka, 25. Recepcioni

Fig.38. Skema funksionale e objektit 'Shkolla për të gjithë'

Përmbajtjet e kujdesit ditorë zhvillohen në segmentin e tretë dhe të katërt (apo të parin nga e djathta të hyrje të objektit). Në një sipërfaqe prej 107 m², nxënësit mund të zhvillojnë aktivitete të lira në grupe më të vogla, pas përfundimit të mësimit të obligueshëm. Këto kthina mund të shfrytëzohen edhe nga punonjësit socialë dhe asistentët e tjerë profesionistë. I tërë grupacioni i kujdesit ditor ndahet përmes një korridori degazhues, ndërsa është i paraprirë nga kthina për muzikë (56 m²), e cila ka dalë të jetë kërkesë edhe e pjesëmarrësve të punëtorisë. Kjo kthinë nuk është e ndarë fizikisht, por është e konceptuar më tepër si një hapësirë për shumë qëllime, në të cilën mund të organizohen edhe shfaqje teatrale dhe aktivitete të tjera përcjellëse. Ajo është e qasshme edhe nga komuniteti dhe është e vendosur në një distancë të shkurtër nga hyrja.

Kino/ Salla multifunkionale është menduar të shërbej edhe si studio e 'sensorëve' në raste të caktuara. Shkallarët nuk janë dimensionuar në ramje si te kinematë klasike, por egziston vetëm një disnivelim i vogël, me qëllim të rritjes së numrit të ulëseve për persona në karroca.

Në mes të kinemasë dhe kthinës për muzikë vie grupacioni i dytë i toaleteve, me qëllim që të shërbej edhe për partinë hyrëse dhe hapësirën e bibliotekës. Biblioteka është e sistemit të hapur, me mundësi shfrytëzimi për të gjitha kategoritë e PAK. Pozicionimi i saj është në afërsi të hyrjes dhe recepcionit, me qëllim që të shfrytëzohet dhe nga fëmijët e lagjes apo komuniteti në tërësi, të cilët e zhvillojnë mësimin në këtë objekt.

Të gjitha segmentet rrethohen me korridorin e brendshëm të gjerësisë 250 cm, i cili ofron vizuara nga oborri i brendshëm dhe pjesa e gjelbëruar, por në të njejtën kohë



Fig.38. Imazh i oborrit të brendshëm 'Shkolla për të gjithë'

mundëson lidhje të shpejtë në mes të segmenteve. Në këtë mënyrë nxënësit mund të ndjekin korridorin e brendshëm për të shkuar te një segment i caktuar, apo mund të dalin në oborrin e brendshëm dhe përmes tij të qasen në segmentin e vënë si cak. Kjo lojë/lëvizje në mes të hapësirës së brendshme dhe asaj të jashtme, stimulon nxënësit me aftësi të kufizuara që vazhdimisht të përballen me botën e brendshme dhe të jashtme, me qëllim të thyerjes së barrierave figurative se ata 'duhet të fshihen' në ambientet e brendshme (shtëpitë e tyre) larg syve të tjerëve.

Shtrirja e objektit në horizontale lehtëson sidomos lëvizjen e personave me karrocë dhe atyre me pengesa në shikim, përderisa konfiguracioni i planimetrisë stimulon ecjen interaktive nga një hapësirë funksionale në tjetrën. Objekti ka ndriçim bilateral dhe me qëllim të ofrimit sa më të madh të ndriçimit natyror (si lehtësi për personat me pengesë në shikim), lartësia e etazhës rritet në disa segmente të objektit.

Organizimi konceptual i bazës së objektit 'Shkolla për të gjithë' është prezentuar më poshtë, ndërsa lidhjet funksionale janë prezentuar përmes shiritëve me ngjyra:



Fig.39. Organizimi funksional i objektit 'Shkolla për të gjithë'

Kontakti me hapësirat e jashtme është ilustruar përmes imazhit të mëposhtëm, në të cilin është prezentuar në fokus hapësira e lojërave për fëmijë. Me qëllim të evitimit të fatkeqsive të mundshme, në këtë hapësirë është propozuar që të shtrohet paraprakisht material i ngjeshur, i cili do t'i amortizonte goditjet. Lojërat janë të përshtatura për të gjitha kategoritë e PAK, duke qenë të distancuara nga dyshemeja dhe duke mundësuar qasje edhe nga personat me karrocë.



Fig.40. Organizimi i hapësirës së jashtme, lojërat për fëmijë

Materializimi i objektit në eksterier është uniform, duke tentuar në ruajtjen e thjeshtësisë dhe qetësisë në volumetri. I tërë objekti është propozuar të jetë i mbështjellur nga druri, duke patur parasysh në përshtatshmërinë e tij si material. Thellësitë e hapjeve përmes aplikimit të ngjyrave sjellin dinamikë në përjetimin e objektit. Edhe në enterier dominon druri, përderisa mobiliari është i punuar me tone të lehta të ngjyrës me qëllim të krijimit të një ambienti më dinamik. Por përgjithësisht format janë të qarta dhe të thjeshta me qëllim të mos krijimit të konfuzitetit të



Fig.41. Dukja lindore e objektit 'Shkolla për të gjithë'

mundshëm të nxënësit me aftësi të kufizuara. Klasët sugjerohet të jenë mirë të ndriçuara me ndriçim natyror. Mobiliari është përshtatur për personat përdorues të karrocave dhe mjeteve të tjera të mobilitetit. Tavolinat janë pa pengesa në depërtim të karrocës (përveç mbajtëseve minimale anësore) dhe tabela për shkrim është e ulur në parapet 40 cm në mënyrë që të arrihet nga nxënësit shtatëshkurtër dhe ata me karroca.



Fig.42. Imazhe të enterierit të klasëve

Rëndësi të posaqme gjatë fazës së konceptimit të objektit shkollor dhe rehabilitues i është kushtuar qasshmërisë dhe komunikimit pa pengesa për të gjitha kategoritë e PAK. Është menduar që të promovohet lëvizja e tyre pa pengesa dhe pa përcjellës, njëllë si e nxënësve të tjerë.



Fig.43. Qasja dhe komunikimi i PAK në objektin 'Shkolla për të gjithë'

Projekti konceptual i objektit 'Shkolla për të gjithë' është produkt i punëtorisë për vizionimin e shkollës gjithëpërfshirëse, dhe si i tillë është bazuar në kërkesat dhe nevojat e kontribuesve në punëtori. Poashtu është i bazuar në shembuj të shkollave të realizuara si dhe në literaturën e profilizuar për këtë kategori objektësh. Duke qenë se është vetëm një koncept ide për realizimin e shkollës gjithëpërfshirëse, mund të konsiderohet si pikë nisje për projektimin e projektit ideorë të një objekti shkollor dhe rehabilitues që do të integronte nxënësit me aftësi të kufizuara së bashku me nxënësit e tjerë në një sistem edukimi të përbashkët!

LITERATURA

'Designing for disabled children and children with special education al needs',

Guidance for mainstream and special schools,

Building Bulletin 102

The Government of England, Department for Children, Schools and Families

'Schools and Kindergartens',

A design manual,

Mark Dudek

'Udhëzues për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore',

Udhëzimet e përgjithshme

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit,e Shkencës dhe e Teknologjisë

'Igriva Arhitektura',

Priročnik sa izobraževanje o grajenem prostoru

Zavod Republike Slovenije za šolstvo

'Udhëzues për projektimin e ndërtesave shkollore',

Normat dhe standardet

Republika e Shqipërisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit

'Udhëzim administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara',

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / EC Ma Ndryshe

'Udhëzues për normat dhe standardet e ndërtesave shkollore',

Udhëzimet e përgjithshme

Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit,e Shkencës dhe e Teknologjisë

Udhëzimi Administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara

Nr. 33/2007

Republika e Kosovës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Ligji për Arsimin në Komunitet e Kosovës,

Ligji Nr. 03/L-06

Republika e Kosovës, Kuvendi

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional

Ligji Nr. 04/L-138

Republika e Kosovës, Kuvendi

6.0. SHTOJCAT

6.1. Pyetësori

6.2. Projekti konceptual 'Shkolla për të gjithë'

PUNËTORIA: SHKOLLA MODEL

28.06.2016

EMRI DHE MBIEMRI (Opcionale) _____

Shkolla (Opcionale) _____

Mosha _____

MJETI 1: PËRVOJA LIDHUR ME OBJEKTET SHKOLLORE EKZISTUESE

1. A e vijoni shkollimin elementar

- ☐ Po
- ☐ Jo

2. Nese jo, përshkruani arsyen e mosvijimit të shkollimit

3. Nese po, sa jeni të kënaqur me shkollën të cilën e vijoni?

- ☐ Shumë
- ☐ Mesatarisht
- ☐ Aspak

4. Sa shpesh hasni në pengesa për të shkuar deri në shkollën tuaj?

- ☐ Gjithmonë
- ☐ Shpesh
- ☐ Nganjëherë
- ☐ Rrallë
- ☐ Asnjëherë

5. Listo pengesat të cilat i hasni në shkollën tuaj

☐
-

- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐

6. Listo pengesat të cilat i hasni rrugës për në shkollën tuaj

- ☐
- ☐
- ☐
- ☐
- ☐

7. Çka do të lehtësonte qasjen tuaj në shkollën tuaj (nëse keni hasur në pengesa)

- ☐ Transporti publik (autobusët),
 - ☐ Hapësira për parkim
 - ☐ Shenjat treguese
 - ☐ Rampat/dorezat mbajtëse
 - ☐ Materializimi në dysHEME
 - ☐ Semaforët me alarm
 - ☐ Tjetër
-

8. Çka do të përmirësonte vijimin e mësimi në shkollën tuaj

- ☐ Çasja më e mirë në objekt
 - ☐ Klasat e përshtatura për nevojat tuaja
 - ☐ Sanitarët/Toaletet e përshtatura për nevojat tuaja
 - ☐ Rampat/dorezat mbajtëse
 - ☐ Materializimi në dysHEME
 - ☐ Tjetër
-

PROJEKTI KONCEPTUAL
OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES
'SHKOLLA PËR TË GJITHË'
SITUACIONI
1:500




PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES

'SHKOLLA PËR TË GJITHË'

BAZA



1:500



PROJEKTI KONCEPTUAL
OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES
'SHKOLLA PËR TË GJITHË'
BAZA
1:250



PROJEKTI KONCEPTUAL
OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES
'SHKOLLA PËR TË GJITHË'
PRERJET
1:250



PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES

'SHKOLLA PËR TË GJITHË'

DUKJET

1:250



Fasada Jugore



Fasada Veriore

PROJEKTI KONCEPTUAL
OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES
'SHKOLLA PËR TË GJITHË'
DUKJET
1:250



Fasada Lindore



Fasada Perendimore

PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES
'SHKOLLA PËR TË GJITHË'



PROJEKTI KONCEPTUAL
OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES
'SHKOLLA PËR TË GJITHË'



PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES
'SHKOLLA PËR TË GJITHË'



PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES

'SHKOLLA PËR TË GJITHË'



PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES

'SHKOLLA PËR TË GJITHË'



PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES

'SHKOLLA PËR TË GJITHË'



PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES

'SHKOLLA PËR TË GJITHË'



PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES

'SHKOLLA PËR TË GJITHË'



PROJEKTI KONCEPTUAL

OBJEKTI SHKOLLOR DHE REHABILITUES
'SHKOLLA PËR TË GJITHË'

